



“Në bazë të nenit 2,2.1, nenit 13 dhe 13.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-049, nenit 12.2 (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-040 dhe nenit 25 pika 10 të Statutit të Komunës së Deçanit”, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e vet te mbajtur me 13.01.2012, miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË TAKSAVE DHE NGARKESAVE
PËR SHËRBIMET KOMUNALE (TEKST I SPASTRUME)

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohet lartësia e taksave dhe ngarkesave për shërbimet e ofruara qytetarëve dhe personave juridik, nga institucionet komunale te komunës se Deçanit.

Neni 2.

Qytetarët dhe personat juridik janë të obliguar të paguajnë taksat dhe ngarkesat për shërbimet e ofruara nga organet komunale te administratës sipas kësaj Rregullore.

Neni 3.

Institucionet komunale janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve qytetarëve dhe subjekteve juridike, mbledhjen e taksave dhe ngarkesave në bazë të kësaj Rregullore, sigurimin dhe depozitimn e të hyrave në llogari adekuate zyrtare bankare.

Neni 4

4.1. Të gjitha institucionet komunale janë të obliguara që ta respektojnë këtë Rregullore.

4.2. Drejtoria komunale për Buxhet dhe financa është e autorizuar të zbatojë këtë rregullore, nën mbikqyerjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Për të gjitha pagesat për shërbimet e ofruara institucionet komunale janë të obliguara të lëshojnë fletëpagesën si dëshmi

Neni 6

Komuna mund të mbledhë taksa dhe ngarkesa tjera qe nuk përfshihen në këtë rregullore në pajtim me Ligjin.

HYRESH-MALIMIA-INGOHRG	
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • DEÇANI • DECANI • DECANI • DECANI • DECANI	
Nga:	508
Që:	
From:	
Nr. i faturave:	01
Br. Serencia:	2012
No. Pages:	
DEÇANI DEÇANE	

Neni 7

7.1 Tarifa nr.1 përfshinë taksat që inkasohen për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme si vijon:

Tarifë nr. 1.

Shërbimet	Shuma/€
1.1. Për çdo kërkesë të parashtruar.....	0.50
1.2. Për aplikacion – pjesëmarrje në konkurs	1.00
1.3. Për çdo dorëzim të ankesës kundër vendimit të shkallës së parë	2.00
1.4. Për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës së lindjes, vdekjes apo kurorës.....	1.00
1.5. Procedura e kurorëzimit në zyre	8.00
1.6. Procedura e lidhjes së kurorëzimit brenda selisë së shërbimit, jashtë orarit zyrtar..	40.00€
1.7. Procedura e kurorëzimit jashtë selisë gjat orarit zyrtar.....	50.00
1.8. Procedura e kurorëzimit jashtë selisë dhe jashtë orarit të rregullt të punës..	70.00
1.9. Për aktvendimin e lëshuar për ndryshimin në statusin civil.....	3.00
1.10. Për vërtetime, certifikata, njoftime, autorizime etj	2.00
1.11. Për vërtetimin e kopjeve të dokumenteve origjinal për një akt	1.00
1.12. Fotokopjimi i dokumenteve (një faqe)	0.10
1.13. Deklarata me dëshmitarë – për një dëshmitar	2.00
1.14. Për shërbimet jashtë selisë së organit (sigurimi i transportit).....	10.00
1.15. Gjetja e dokumenteve në arkivin e drejtorisë	2.00
1.16. Lëshuarja e akteve me foto	5.00
1.17. Dërgimi i faksit brenda territorit të Kosovës, për një faqe	0.50
1.18 Dërgimi i faksit brenda territorit Evropës, për një faqe	1.00
1.19. Dërgimi i faksit jashtë kontinentit të Evropës për një faqe	2.00
1.20. Plotësimi dhe vërtetimi i formularve për përdorim në botën e jashtme	5.00
1.21. Kontributi për pjesëmarrje në tender përcaktohet në vetë tekstin e shpalljes së tenderit. -	
1.22. Oferta për tokë, shtëpi, banesë.....	2.50
1.23. Vërtetimi për termat, luftë etj	1.00
1.24. Certifikata që posedon banesë	1.00
1.25. Kërkesat për pronarët për ndërrimin e emrit ose mbiemrit.....	2.50
1.26. Konkluzat.....	2.50
1.27. Lëshimi i Aktvdekjeve.....	lirohet nga pagesa

7.2. Nga pagesa e tarifave për shërbimet e kryera në bazë të paragrafit 1 të këtij neni lirohen:

a) Pala dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngushta (babai, nëna, bashkëshorti-ja dhe fëmijët) që marrin ndihmë sociale nga Qendra për punë sociale në Deçan, pas verifikimit të dëshmive të lëshuara nga QPS-ja.

b) Lirohen nga pagesa invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve dhe të viktimave të luftës si dhe nxënësit dhe studentët për nevoja shkollore (me përjashtim të tarifës nr.1 pika 5) në bazë të provave të prezantuara para organit respektivisht zyrtarit kompetent.

7.3. Pagesat bëhen në xhirollogarinë e KK-Deçan, apo drejtpërdrejt në arkën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa me ç'rast lëshohet dëshmia e pagesës.

Neni 8

Tarifa nr.2 përfshinë taksat që paguajnë subjektet afariste për dhënien e licencës për plotësimin e kushteve minimale higjeniko-teknike dhe të mbrojtjes në punë që lëshohet nga komisioni përkatës si vijon:

Tarifa nr. 2.

	Shuma €
2.1 Objektet industriale	100.00
2.2 Shitja e derivateve të naftës (pompat e benzinës)	100.00
2.3 Restorantet, hotelet dhe motelet	100.00
2.4 Ordinancat, barnatoret dhe laboratorët bio-kimike	100.00
2.5 Barnatoret bujqësore	75.00
2.6 Vetëshërbimet	75.00
2.7 Kuzhinat (gjellëtoret)dhe qebaptoret.....	75.00
2.8 Ëmbëltoret, kateterit, byrektoret.....	75.00
2.9 Dyqanet tregtare të pavarura	50.00
2.10 Dyqanet e pavarura zejtare	50.00
2.11 Zyret dhe agjencitë	50.00
2.12. Kiosqet	25.00
2.13. Të tjerat të cilat nuk janë të përfshira në këtë numër tarifor.....	50.00

Neni 9

Tarifa nr.3 përfshinë taksat që inkasohen për ushtrimin e veprimtarisë afariste në territorin e komunës së Deçanit dhe paguhen në baza vjetore si vijon:

Tarifa nr. 3.

3.1 Veprimtarit Prodhuese

3.1.1. Prodhuesit e energjisë elektrike	500.00
3.1.2. Kompanitë shoqërore dhe publike	250.00
3.1.3. Prodhuesit e pijeve alkoolike	250.00
3.1.4. Prodhuesit e pijeve joalkoolike	200.00
3.1.5. Prodhuesit e materialit ndërtimor	200.00
3.1.6. Prodhuesit e mobileve	200.00
3.1.7. Gurthyesit	250.00
3.1.8. Ndërmarrjet ndërtimore.....	250.00

3.2 Veprimtarit përpunuese

3.2.1. Përpunuesit e prodhimeve të mishit dhe thertoret	250.00
3.2.2. Përpunuesit e Qumështit	70.00
3.2.3. Përpunuesit e prodhimeve natyrore ushqimore.....	100.00
3.2.4. Përpunuesit e elementeve të plastikes,aluminit etj	250.00
3.2.5. Metalpunuesit	100.00
3.2.6. Punuesit e gurëve të varrezave	100.00
3.2.7. Rikup. e mbeturinave dhe hedhurinave metalike dhe jo met.	100.00

3.3 Veprimtarit Bankiere, lojëra fati e të ngjashme

3.3.1. Bankat ekspoziturat	350.00
3.3.2. Këmbimoret	200.00
3.3.4. Kompanitë e sigurimeve	350.00

3.4 Agjensionet e te ngjashme

3.4.1. Agjensionet e shpedicionit dhe autotregjet	250.00
3.4.2. Agjencitë e sigurimit të automjeteve.....	100.00
3.4.3 Agjencitë turistike	170.00
3.4.4. Agjencitë për transferim te parave	170.00

3.5 Veprimtarit tregtare

3.5.1 Pompat e benzinës.....	350.00
3.5.2. Shitoret ushqimore dhe të tekstilit	100.00
3.5.3. Supermarketet dhe vetëshërbimet	200.00
3.5.4. Shitoret e teknikës së bardhë dhe hekurishtet	150.00
3.5.5. Shitoret e autopjesëve dhe autogomave	150.00
3.5.6. Shitoret e lëkur këpucëve.....	100.00
3.5.7. Shitoret e mobileve dhe tepihëve	200.00
3.5.8. Shitoret e teknikes informative.....	200.00
3.5.9. Shitoret e ngjyrës dhe llaqeve	150.00
3.5.10. Podrumet (depot e pijeve)	100.00
3.5.11. Depot e materialit ndërtimor.....	250,00
3.5.12 Libraritë	100.00
3.5.13 Shitoret optike, kozm., bizhut., lulishtet, videoklubet	100.00
3.5.14. Mobil shopat	100.00
3.5.15. Barnatoret bujqësore dhe shëndetësore	150.00
3.5.16. Tregtarët lëvizës	50.00
3.5.17. Kiosqet.....	30.00
3.5.18. Frigoriferët	30.00

3.6 Sherbime hoteliere dhe ushqimore

3.6.1. Hotelet.....	300.00
3.6.2. Motelet	250.00
3.6.3. Restorantet	200.00
3.6.4. Kafiteritë.....	170.00
3.6.5. Mishtoret, gjellëtoret, qebaptoret dhe bukëpjekësit	100.00

3.7 Veprimtari zejtare

3.7 1.Vullkanizorët dhe teneqepunuesit	70.00
3.7.2. Prerësit e automjeteve të vjetra	170.00
3.7.3. Autoserviset, autoelektracistët, elektroserviset.....	100.00
3.7.4 Metalpunuesit	100.00
3.7.5. Fotografistët,orëtarët	70.00
3.7.6. Rrobaqepësit	70.00
3.7.7. Këpucëtarët	30.00
3.7.8. Argjendarët	150.00
3.7.9. Zdrukthëtarët.....	100.00
3.7.10 Frizerët	100.00
3.7.11.Moler-gipserët, punëtorit e elementeve të betonit	170.00
3.7.12. Punuesit e mbishkrimeve të firmave	70.00
3.7.13 Instaluesit e rrymës, ujit	70.00

3.8 veprimtari profesionale

3.8.1. Avokatët	200.00
3.8.2. Rëntgenët, Laboratorët,ordinancat mjekësore.....	150.00
3.8.3. Byrot Projektuese.....	100.00
3.8.4. Shërbimet financiare dhe kontabiliste	100.00
3.8.5. Shërbimet veterinerë	100.00
3.8.6. Shkollat Private.....	100,00

3.9 Veprimtari tjera shërbyese

3.9.1. Ndërmarrjet e taksive dhe autoshkollat.....	200.00
3.9.2 Vend parkingjet	100.00
3.9.3.Internetet.....	100.00
3.9.4. Autolarësit	70.00
3.9.5. Lojërat e ndryshme	100.00
3.9.6.Autotrasportuesit Taxi.....	70.00
3.9.7 Ekskavatorët	150.00
3.9.8. Autotaksitë për pasagjerë	30.00
3.9.9. Shpuesit e puseve	150.00
3.9.10 Basenet	150.00
3.9.11. Fushat sportive të mbyllura	200.00
3.9.12. Fushat sportive të hapura	100.00
3.9.13. Shtypshkronjat	200,00
3.9.14. TV-të	200.00
3.9.15. Radiot	100.00

3.10 Veprimtarit e pa përfshira ne nr. Tarifor 3..... 70,00

9.2 Bizneset afariste që operojnë në më shumë lokacione me firmë dhe leje të njëjtë për secilin lokacion paguajnë nga 50% të tarifës përkatëse.

9.3.Bizneset afariste qe operojnë ne zonat rurale paguajnë 20% me pak nga tarifa përkatëse.

9.4 Subjektet te cilat regjistrohen ne gjysmën e par te vitit, paguajnë 100% te tarifës përkatëse ndërsa ato qe regjistrohen ne gjysmën e dytë paguajnë 50%.

9.5. Kontributet nga paragrafi 9.1.tarifa 3 i këtij neni paguhen në 4 këste (15 janar, 15 prill, 15 korrik dhe 15 tetor)

9.6. Për moskryerjen e obligimit me kohë merren masa ndëshkuese me kamatë mujore prej 2%.

9.7 Bizneset e reja prodhuese që kanë të punësuar mbi pesë (5) vetë Lirohen nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë afariste për periudhën prej pesë viteve

9.8 bizneset e reja prodhuese lirohen nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë për periudhën prej tri viteve.

9.9 . Lirohen nga çdo taksë komunale veprimtaritë tradicionale zejtare

Neni 10

Tarifa nr.4 përfshinë taksat dhe detyrimet e qytetarëve dhe subjekteve tjera në procedurën e pranimit, përpunimit dhe lëshimit të lejeve ndërtimore dhe ofrimin e shërbimeve tjera teknike nen kompetencën e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Ndërtim, kompensimin për

rregullimin e tokës ndërtimore, shpërndarjen e objekteve në pronësi komunale dhe navesës publike.

Tarifë Nr. 4

	Sh. €
4.1. Për dhënien e kushteve të lokacionit brenda planit rregullues:	
4.1.1. Për objekte individuale dhe kolektive të banimit.....	10.00
4.1.2. Për objekte afariste – ekonomike industriale	15.00
4.1.3. Për garazhe, posllom, muri etj në kuadër të ngastrës kadastrale	5.00
4.1.4. Per objekte të përziera- banim dhe afarizëm.....	12.00
4.1.5. Per Objekte publike.....	15,00
4.1.6. për objekte bujqësore shuma-----	15 euro.
4.2. Për dhënien e kushteve të lokacionit jashtë planit rregullues me vëzhgim në vend të ngjarjes:	
4.2.1. Për objekte individuale dhe kolektive të banimit.....	20.00
4.2.2. Për objekte afariste – ekonomike – industriale	30.00
4.2.3. Per objekte të përziera -banim plus afarizëm.....	25.00
4.2.4. Per objekte publike	25,00
4.2.5. Për objekte bujqësore	25.00
4.3. Për ndryshim – plotësim të planit rregullativ me shiqim në vend të ngjarjes:	
4.3.1. Për parashtrim të kërkesës	3.00
4.3.2. Nëse ndryshimi – plotësimi aprovohet	25.00
4.4. Për dhënien e pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme	
4.4.1. Për objektet. e përkohshme montuese, baraka, kioske, garazhe etj në sipërfaqe publike	15.00
4.4.2. Për objekte të përkohshme montuese baraka, kioske, garazhe në sipërfaqe private.....	10.00
4.4.3. Për objekte afariste – ekonomike etj depo, servise, magazina	25.00
4.4.4. Për objekte lëvizëse frigorifer, aparate, tavolina etj	10.00
4.4.5. Per objekte publike.....	25,00
4.5. Per dhenjen e lejes urbanistike:	
4.5.1. Mbrenda planit Rregullues.....	30.00
4.5.2. Jashtë planit Rregullues	50.00
4.6. Për përcaktimin e vijës së ndërtimit dhe vijës së rregullimit	
4.6.1. Për objekte të banimit	20.00
4.6.2. Për objekte afariste – ekonomike – industriale	50.00
4.6.3. Për objekte të përkohshme montuese	25.00
4.6.4. Per objekte publike.....	50,00
4.6.5. Për objekte bujqësore.....	25,00
4.7. Për dhënien e lejes së përdorimit (shfrytëzimit) të objekteve	
4.7.1. Për objektet e banimit deri 1000 m ²	25.00
4.7.2. Për objektet e banimit mbi 1000 - 5000 m ²	50.00
4.7.3. Për objektet e banimit mbi 5000m ²	75.00
4.7.4. Për objekte afariste – ekonomike – industriale deri në 1000m ²	30.00
4.7.5. Për objekte afariste–ekonomike–industriale mbi 1000m ² -5000m ²	60.00
4.7.6. Për objekte afariste – ekonomike – industriale mbi 5000m ²	100.00
4.7.7. Për objekte të përkohshme montuese	15.00
4.7.8. Për objektet publike me sipërfaqe deri në 1000 m ²	30.00
4.7.9. Për objektet publike me sipërfaqe mbi 1000 m ²	60.00
4.7.10. Për objekte bujqësore.....	25.00

4.8. Për vizitë në vend të ngjarjes sipas kërkesës së palës

4.8.1. Dhënia e vërtetimit mbi vjetërsinë – gjendjen e objektit	7.00
4.8.2. Konstatimi i komisionit lidhur me zgjerimin e objektit ekzistues	5.00
4.8.3. Konstatimi i komisionit lidhur me zgjerimin e objektit ekzistues pas aprovimit	25.00
4.8.4. Për dhënien e pëlqimit për mirëmbajtje vijuese të objektit	10.00

4.9. Përpunimi I lëndës sipas kërkesës së palës

4.9.1. Përpunimi, përcjellja e lëndëve – kërkesave, ankesave, prapësimeve, lëshimi I vërtetimeve në bazë të dokumentacionit ekzistues	3.00
---	------

4.10. Kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore me rastin e dhënies se lejes ndërtimore për ndërtimin e objekteve kolektive për banim dhe afarizëm (Neto sipërfaqja)

4.10.1 Zona e parë:

PËRDHESA

- Afarizmi	15.00 €/m ²
-Banimi.....	8.00 €/m ²

KATET

-Afarizmi	10.00 €/m ²
-Banimi	6.00 €/m ²

BODRUMET

- Bodrumet afariste	8.00 €/m ²
- Bodrumet e banimit	4.00 €/m ²

NDËRKULMET, MANSARDAT

BALLKONET

SIP. E PËRBASHKËTA (shkallët dhe haps. për shumë qëllime)

4.10.2 Zona e dytë:

Vlera e kompensimit nga zona e parë (I) zbritet për 20%

4.10.3 Zona e tretë:

Vlera e kompensimit nga zona e parë (I) zbritet për 30%

4.11 Ndërtimi i objekteve individuale për banim dhe afarizëm (Neto sipërfaqja).

4.11.1 Zona e parë:

PËRDHESA

- Afarizmi	12.00 €/m ²
- Banimi	5.00 €/m ²

KATET

- Afarizmi	8.00 €/m ²
- Banimi	4.00 €/m ²

BODRUMET

- Bodrumet afariste	4.00 €/m ²
- Bodrumet e banimit	2.00 €/m ²

NDËRKULMET, MANSARDAT

-Ndërkulmet ,mansardat afariste	4.00 €/m ²
- Ndërkulmet, mansardat e banimit	2.00 €/m ²

BALLKONET

-Sipërfaqet e përbashkëta (shkallët, rampat dhe pasazhi).....

4.11.2 Zona e dytë:

Vlera e kompensimit nga zona e parë (I) zbritet për 20%

4.11.3 Zona e tretë:

Vlera e kompensimit nga zona e parë(I) zbritet për 30%

4.12. Tarifa e shfrytëzimit të tokës për metër gjatësi për vit ,

